

## KORÇA

Korça është qendra më e madhe administrative e Shqipërisë juglindore, qyteti më i madh i rajonit i themeluar në shekullin 15-të. Megjithëse jeta qytetare lindi në mesjeten e vonët, terreni ka qene i banuar shumë shekuj me pare .Rajoni i Korçës është një nga qendrat më të rëndësishme kulturore dhe ekonomike të Shqipërisë.Vendlindja e muzikës qytetare , vend i bukurisë natyrore me liqenet , zonat malore dhe parqet kombëtare.

Studiuesit kanë vërtetuar se zona ku ndodhet sot qyteti ka qene e banuar që në kohët e lashta.Gjatë epokave të antikitetit ka pasur një lulëzim jete,ky i përqëndruar më tepër në rreze të kodrave të Korçës.

Pas ardhjes të Iliaz Bej Panaritit në fshatin e Peshkëpisë që ndodhet afër qytetit , Korça pësoi shumë ndryshime. Ai ndërtoi një xhami të madhe në vitin 1496 si dhe pazarin e Korçës .Në shekullin XVII- XVIII qyteti u zgjerua , sidomos pas djegies të Voskopojës .

Në gjysmën e dytë të shekullit të XIX , Korça u bë një nga qendrat më të rëndësishme ekonomike , tregëtare dhe kulturore të vendit , me një Pazar të madh dhe karakteristik , i cili ze një vend të veçantë midis monumenteve të kulturës të qyteteve të tjera të Shqipërisë .Gjatë viteve të Rilindjes Kombëtare në Korçë u zhvillua një veprimtari e gjerë patriotike e mbështetur nga shumë atdhetarë ku fryt i punes të tyre ishte dhe hapja e Shkollës të parë Shqipe. Me 10 dhjetor 1916,si rezultat i përpjekjeve të patriotëve korçarë me në krye Themistokli Germenjin u shpall Krahina Autonome e Korçës.

Në vitet e formimit të shtetit Shqiptar, Korça dallohej nga qytetet e tjera për nga pikpamja e zhvillimit ekonomik,kulturor dhe urban.Në dekadat e para të shekullit të XX, Korça u bë një nga qytetet me aktivitet më të dendur kulturor , arsimor dhe publicistik dhe në tetor të vitit 1917 u cel Liceu i Korçës i cili pergatiti breza intelektualesh që lanë gjurmë në historinë dhe kulturën kombëtare. Periudha e regjimit komunist , si kudo në Shqipëri ndikoi negativisht, duke luftuar ashpër shtresa intelektuale dhe tregetare të qytetit.

Sot Korça, në aspektin kulturor dhe arsimor vazhdon ti ruaje dukshëm traditat e saj duke u renditur ndër qytetet e para në Shqipëri

## KORÇA

Korça is the largest administrative center in Southeastern Albania, the largest city in the region founded in the 15th century. Although civil life was born in the late Middle Ages, the land has been inhabited many centuries ago. Korça is one of the most important cultural and economic centers in Albania. The birthplace of civic music, a natural beauty spot with lakes, mountainous areas and National parks.

Researchers have proved that the area where the city is today has been inhabited since ancient times. During the antiquity ages there has been a flourishing of life, which is more focused on the radius of the hills of Korça.

After the arrival of Iliaz Bey Panariti in the village of Peshkëpi, which is near the town, Korça underwent a lot of changes. It built a large mosque in 1496 and Korça bazaar. In the 17th and 18th centuries the city expanded, especially after the burning of Voskopoja.

In the second half of the 19th century, Korça became one of the most important economic, commercial and cultural centers of the country, with a large and characteristic shopping, which occupies a special place among the cultural monuments of other cities Albania During the years of the National Renaissance in Korça, a wide patriotic activity was held, supported by many patriots, where the fruit of their work was the opening of the first Albanian School. On December 10, 1916, as a result of the efforts of the Korça patriots, the Themistoc Germien was declared the Autonomous Province of Korça